



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI  
VENDIM

Nr. 126, Datë 06.05.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS TIP PËR  
VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNK-SË ME PËRMASA  
TË VOGLA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 16, 22, pika 2, gërma “f” dhe 23 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, 17.06.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 06.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1527 prot., datë 06.05.2026, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës Tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla”;

**Konstatoi se:**

- Në zbatim të neneve 16, pika 11; 22, pika 2, gërma “f” dhe nenit 23 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, ERE ka autoritetin për të miratuar licencën dhe kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, si dhe përcakton kushtet dhe kriteret e licencimit për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e gazit natyror.
- Licenca Tip e hartuar nga ERE, parashikon detyrimin e të licencuarit për të projektuar, ndërtuar, operuar dhe mirëmbajtur impiantet e GNK-së me përmasa të vogla në përputhje me standardet teknike kombëtare dhe ndërkombëtare të aplikueshme, përfshirë standardet ISO, normat europiane (EN), si dhe rregullat teknike për pajisjet nën presion, mbrojtjen kundër shpërthimit (ATEX), mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë industriale, duke garantuar disponueshmërinë e kompresorëve, depozitave të presionit, sistemeve të tubacioneve, valvulave të sigurisë dhe pajisjeve të tjera teknologjike të certifikuar sipas standardeve të Bashkimit Europian dhe legjislacionit shqiptar.
- Kushtet e Licencës Tip sanksionojnë detyrimin e të licencuarit për të siguruar që impiantet e GNK-së me përmasa të vogla të pajisen me sisteme automatike të ndalimit emergjent (Emergency Shutdown System – ESD), sisteme detektimi të rrjedhjeve të gazit, sisteme mbrojtjeje kundër zjarrit dhe shpërthimit, ventilim teknik të përshtatshëm, sinjalistikë sigurie dhe zona të klasifikuara sipas kërkesave ATEX, si dhe me personel të trajnuar dhe të certifikuar për operime me gaz natyror dhe pajisje nën presion.
- Licenca Tip parashikon detyrimin e të licencuarit për të hartuar dhe zbatuar plane emergjence, procedura evakuimi dhe masa reagimi ndaj incidenteve industriale, duke garantuar raportimin e menjëhershëm pranë ERE-s dhe institucioneve kompetente për çdo incident teknik, rrjedhje

gazi, shpërthim apo situatë me risk të lartë, si dhe kryerjen e kontrolleve periodike teknike të të gjitha pajisjeve dhe infrastrukturës së impiantit.

- Licenca Tip parashikon detyrimin e të licencuarit për të mbajtur llogari të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër, si dhe për të dorëzuar bilance financiare vjetore pranë ERE-s brenda datës 31 mars të çdo viti, duke raportuar periodikisht të dhëna operative, financiare dhe sasiore, përfshirë shpenzimet dhe të ardhurat operative, pasqyrat e rrjedhës së parasë, sasitë e GNK-së të transportuara, numrin e klientëve të shërbyer, si dhe ankesat e regjistruara dhe trajtimin e tyre, në zbatim të nenit 30 dhe të kërkesave të raportimit sipas nenit 16, pika 24 të ligjit nr. 102/2015.
- Kushtet e Licencës Tip garantojnë aksesin objektiv dhe jodiskriminues të palëve të treta në shërbimet e ofruara nga i licencuari, duke ndaluar çdo formë diskriminimi ndërmjet përdoruesve ose grupeve të përdoruesve, sidomos kur ky diskriminim favorizon shoqëritë e lidhura, si dhe duke parashikuar detyrimin e të licencuarit për të mbrojtur informacionin konfidencial me natyrë tregtare të marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë.
- Licenca Tip parashikon mekanizma të qartë për zbatimin e masave administrative dhe heqjen e licencës nga ERE, në rastet kur i licencuari nuk përmbush kushtet thelbësore të licencës, rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve, shkel dispozitat për mbrojtjen e mjedisit, ose nuk kryen pagesat rregullatore të vendosura nga ERE, në zbatim të neneve 27 dhe 106 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe rregulloreve përkatëse të miratuara nga ERE.
- Në këtë kuadër, licenca Tip synon të rregullojë ushtrimin e kësaj veprimtarie në mënyrë të unifikuar, duke garantuar respektimin e kërkesave ligjore, standardeve teknike dhe të sigurisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për miratimin e Licencës Tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla (dokumenti bashkëlidhur).
2. Drejtoria e Rregullimit të Gazit Natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**LICENCË  
PËR  
VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNK-SË ME PËRMASA TË  
VOGLA**

Licenca i jepet: \_\_\_\_\_

NUIS: \_\_\_\_\_

Numri i Licencës: \_\_\_\_\_

Seria: \_\_\_\_\_

Data e Hyrjes në Fuqi: \_\_\_\_\_

Kohëzgjatja: \_\_\_\_\_

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në Ligjin nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”) i jep këtë Licencë (“Licenca”), për të kryer veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, Personit të lartpërmendur, i quajtur “I Licencuari”, subjekt i Kushteve të Licencës të bashkangjitura dhe pjesë integrale të saj, si dhe kushteve të përcaktuara nga Bordi në Vendimin e tij.

Kjo Licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi, deri në përfundim të afatit të dhënë në rast se nuk hiqet nga ERE në përputhje me Kushtet e Licencës të përfshira këtu, apo parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.

**KRYETARI I ERE-s**

## **KUSHTET E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNK-SË ME PËRMASA TË VOGLA**

### **Neni 1**

#### **Dispozita të Përgjithshme**

ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur në Kreu III Seksionin I, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj Licence.

1. Nëse ndonjë kusht i kësaj Licence bëhet nul ose i anulueshem apo pushon së qëni në fuqi, ky kusht do të hiqet nga Licenca dhe Kushtet e mbetura të Licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.
2. Në rastet e transferimit të Licencës, I Licencuari ka detyrimin të njoftojë menjëherë ERE-n.
3. ERE ka të drejtën ekskluzive për të modifikuar këtë Licence, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar si dhe për të përmbushur dispozitat e Rregullave për Organizimin e Tregut të Gazit Natyror; Ligji nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Kushteve të Përgjithshme për Furnizimin me Gaz Natyror; Kodit të Rrjetit të Transmetimit; Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes; Kodit të Matjes; dhe/ose akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ERE në zbatim të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, I ndryshuar.

#### **Përkufizimet e termave të përcaktuara në:**

- Ligjin nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” I ndryshuar;
- “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror”, miraturar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 97 datë 04.07.2017;
- “Rregullore mbi procedurat e heqjes së licensave në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miraturar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 58 datë 18.04.2017;
- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe Procedurat e ERE”, miraturar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016,
- Rregullat dhe Rregulloret që i përkasin Sektorit të Gazit Natyror (Legjislacioni në fuqi), përfshihen në këtë Licence për çdo qëllim.

Fjalë dhe fraza të tjera, të përdorura në këtë Licence dhe në Kushtet e Licencës, të cilat nuk përfshihen në ligjet dhe rregulloret e mësipërme, kanë kuptimet si më poshtë vijon:

- **“Gaz Natyror i Komprimuar” (GNK)** është gazi metan CH<sub>4</sub>, i cili komprimohet në presionin 200 atm.”.
- **“Impiant me përmasa të vogla”** është njësi lëvizëse që përdoret për prodhimin/depozitimin, transportimin dhe/ose shpërndarjen e sasive të vogla të GNK-së.

- **“Ndër-Subvencionime”**, do të thotë transferimi i fondeve ose ndarje e kostove ndër llogaritë e të Licencuarit, ose llogaritë me qëllim mbështetjen financiare të një aktiviteti apo biznesi përveç furnizimit, prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror nga të ardhurat e fituara nga i Licencuari që kryen Aktivitetin e Licencuar, ose duke i kaluar kostot të shkaktuara nga i Licencuari gjatë kryerjes së Aktivitetit të Licencuar tek një aktivitet apo biznes tjetër përveç furnizimit, prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror.
- **“Aktivitet i Licencuar”**, do të thotë aktivitetet e lidhura direkt dhe të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, në përputhje me Ligjin nr. 102/2015 *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*, i ndryshuar, Rregullat për Organizimin e Tregut të Gazit Natyror, Kushtet e Përgjithshme për Furnizimin me Gaz Natyror, si dhe Rregullat dhe Rregulloret e tjera që aplikohen.
- **“I Licencuar”**, sikurse përdorur në këtë dokument, do të thotë Personi i përmendur në faqen e parë të kësaj Licence, që mban licencën e lëshuar nga ERE për kryerjen e Aktivitetit të Licencuar.
- **“Procedurat e Licencimit për Sektorin e Gazit Natyror”**, do të thotë procedura e parashikuar në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”*, miraturar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 97, datë 04.07.2017.
- **“Legjislacioni në fuqi”**, do të thotë të gjitha standardet, kodet, rregullat, rregulloret, metodologjitë dhe çdo vendim ose akt tjetër në fuqi, të miratuara nga ERE dhe autoritete të tjera kompetente sipas Ligjit nr. 102/2015 *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*, i ndryshuar.
- **“Informacion me Ndjeshmëri Tregtare”**, do të thotë, të dhëna në lidhje me biznesin ose me natyrë tregtare të Përdoruesve të Sistemit, që zotërohen nga i Licencuari gjatë procesit të ushtrimit të Aktivitetit të Licencuar, të cilat duhet të mbahen konfidenciale.
- **“Informacion me Avantazh Tregtar”**, do të thotë informacion i lidhur me aktivitetin e vetë të Licencuarit, i cili duhet të mbahet konfidencial dhe nuk duhet t’i jepet apo t’i bëhet i ditur të tjerëve në mënyrë diskriminuese.
- **“Forcë madhore”**, është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
- **“Pagesa rregullatore”**, është pagesa vjetore që shoqëritë e licencuara në sektorin e gazit natyror paguajnë në ERE për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij, në bazë të një metodologjie të miraturar nga ERE.

## Neni 2

### Kryerja e Aktivitetit të Licencuar

1. Licencuari autorizohet nga kjo Licencë për të zhvilluar Aktivitetin e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla sipas Legjislacionit në fuqi në Republikën e

Shqipërisë. Në rast se subjekti synon të ushtrojë edhe veprimtari të tjera të rregulluara në sektorin e gazit natyror, si transmetimi, shpërndarja apo depozitimi, ai duhet të pajiset me licencat përkatëse për secilën prej tyre, në përputhje me nenin 22, gërma f. të ligjit nr. 102/2015. Në çdo rast, i licencuari mban llogari të ndara për secilën veprimtari të licencuar, sipas nenit 30 të këtij ligji.

2. I Licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të tentojë të ndalojë të Licencuarit e tjerë ose pjesmarrësit potencialë ose konkurentët që të angazhohen ose të hyjnë në biznesin e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla apo në aktivitete të tjera në sektorin e Gazit Natyror në Republikën e Shqipërisë;
3. I Licencuari nuk do të përfshihet në asnjë formë aktiviteti monopol ose anti-konkurrencë të ndaluar nga Legjislacioni në fuqi ose Rregulloret dhe Rregullat e miratuara nga ERE dhe Autoriteti i Konkurrencës.
4. I Licencuari nuk mund të ushtrojë veprimtari të tjera të rregulluara në sektorin e gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen apo depozitimin e gazit natyror, pa u pajisur me licencën përkatëse nga ERE.
5. Brenda datës 31 Janar të çdo viti, i Licencuari do t'i dërgojë ERE-s një informacion dhe deklaratë me shkrim për kryerjen e aktivitetit gjatë vitit paraardhës dhe përmbushjes së kuadrit ligjor në sektorin e gazit natyror, sipas kërkesave raportimit të vendosura nga ERE sipas nenit 16, pika 24 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.
6. I Licencuari nuk do të bashkëpunojë me persona të tjerë për të dëmtuar interesat e të Licencuarve ose klientëve të Gazit Natyror.
7. I Licencuari do t'a kryejë Aktivitetin e Licencuar në përputhje me parimet e transparencës, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
8. I Licencuari që do të angazhohet në aktivitete të tjera të ndryshme nga Aktiviteti për të cilin është Licencuar, duhet të informojë ERE-n në rastet kur synon të:
  - a) angazhohet në aktivitete tjetër përveç aktivitetit të Licencuar; ose
  - b) të ngrejë një Biznes Shoqërues.
9. ERE mund t'a ndalojë angazhimin në një aktivitet tjetër ose të vendosë kushte të veçanta për ngritjen e Bizneseve Shoqëruese të nevojshëm për të mbrojtur interesat e klientëve.
10. I Licencuari nuk është përgjegjës për mos-përmbushjen e Kushteve të Licencës në rast të një Force Madhore deri në atë shkallë sa Forca Madhore është shkaku për këtë mos-përmbushje të Kushteve të Licencës. Në këtë rast, i Licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të Licencuarit e tjerë ose klientët me të cilët i Licencuari ka lidhur marrëveshje.

### **Neni 3**

#### **Detyrimet e të Licencuarit**

1. I Licencuari është i detyruar të zbatojë Legjislacionin në fuqi dhe gjithë Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Rregulloret e Rregullat e miratuara nga ERE si dhe rregullave specifike që lidhen me kryerjen e aktivitetit nga Institucionet e përcaktuara për të dhënë vertetimet ose certifikimet.

2. I Licencuari është i detyruar të projektojë, ndërtojë, operojë dhe mirëmbajë impiantet e GNK-së me përmasa të vogla në përputhje me standardet teknike kombëtare dhe ndërkombëtare të aplikueshme, përfshirë standardet ISO, EN (Normat Europiane) dhe rregullat teknike për pajisjet nën presion, mbrojtjen kundër shpërthimit (ATEX), mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë industriale.
3. I licencuari në aktivitetin e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, në zbatim të kësaj Licence, duhet:
  - a) të ndërmarrë masat e nevojshme për garantimin e aftësive teknike dhe financiare për kryerjen e aktivitetit të licencuar. Të dorëzojë përmbledhje të projektit, duke përfshirë llojin e impiantit dhe funksionimin e tij të synuar.
  - b) të regjistrohet si pjesëmarrës i tregut shqiptar të gazit natyror pranë operatorit të tregut të gazit natyror, sipas procedurave të regjistrimit dhe do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ERE-s. Emri ligjor i individit ose entitetit, akti i partneritetit dhe dokumentet CNIC/identifikimi, dhe lloji specifik i licencës. Adresa e detajuar, hartat topografike që tregojnë zonat përreth brenda 100 metrave dhe prova e blerjes së tokës.
  - c) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të veprimtarisë së licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tij në përfitim të klientëve dhe të sektorit të gazit natyror.
  - d) të kryejë operimin në impiantet e GNK me përmasa të vogla, në kushte të sigurta, të qëndrueshme dhe eficiente, duke marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të garantojë mjete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit;
  - e) të sigurojë kushte objektive dhe jodiskriminuese, për akses në shërbimin e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla;
  - f) të kufizojë diskriminimin ndërmjet përdoruesve ose grupeve të përdoruesve të shërbimit operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, sidomos kur ky diskriminim favorizon shoqëritë e lidhura;
  - g) të mbrojë informacionin konfidencial, me natyrë tregtare, të marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
  - i) të disponojë kompresorë, depozita presioni, sisteme tubacionesh, valvula sigurie dhe pajisje të tjera teknologjike të certifikuara sipas standardeve të Bashkimit European dhe legjislacionit shqiptar për pajisjet nën presion;
  - j) të sigurojë që impianti të pajiset me:
    - sisteme automatike të ndalimit emergjent (Emergency Shutdown System – ESD);
    - sisteme të detektimit të rrjedhjeve të gazit;
    - sisteme të mbrojtjes kundër zjarrit dhe shpërthimit;
    - ventilim teknik të përshtatshëm;
    - sinjalistikë sigurie dhe zona të klasifikuara sipas kërkesave ATEX;
  - k) të sigurojë që operimi i impiantit të kryhet vetëm nga personel i trajnuar dhe i certifikuar për operime me gaz natyror dhe pajisje nën presion;
  - l) të hartojë dhe zbatojë plane emergjence, procedura evakuimi dhe masa reagimi ndaj incidenteve industriale;

m) të kryejë kontroll periodik teknik.

n) I Licencuari garanton që impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, janë ndërtuar dhe operohen në mënyrë të sigurt, duke minimizuar rrezikun për jetën, shëndetin, pronën dhe mjedisin.

o) I Licencuari është përgjegjës për:

a) zbatimin e kërkesave të sigurisë teknike dhe industriale;

b) kontrollin e integritetit të pajisjeve nën presion;

c) monitorimin e rrjedhjeve dhe emetimeve të gazit;

d) menaxhimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme;

e) respektimin e distancave të sigurisë nga objektet përreth sipas legjislacionit në fuqi.

p) I Licencuari e zhvillon veprimtarinë e tij në referencë dhe zbatim të akteve përaktëse të kolaudimit, certifikatave të konformitetit të pajisjeve, lejet mjedisore dhe kundër zjarrit; procedurave operative standarde dhe manualeve të sigurisë.

Çdo incident teknik, rrjedhje gazi, shpërthim apo situatë me risk të lartë duhet t'i raportohet menjëherë ERE-s dhe institucioneve kompetente.

#### **Neni 4**

#### **Llogaritë dhe Raportimi**

1. I Licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për Aktivitetin e Licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të Licencuara) ku është angazhuar i Licencuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Kur është e nevojshme dhe sipas kushteve të përcaktuara tek Rregullat dhe Rregulloret që aplikohen, këto llogari mund të ofrohen në një formë të konsoliduar. I Licencuari do t'i dorëzojë ERE-s bilance financiare vjetore deri në datën 31 Mars të çdo viti. Nëse I Licencuari ushtron më shumë se një aktivitet, faturat e shpenzimeve për çdo aktivitet që ushtron, duhet të jenë lehtësisht të dallueshme se cilit aktivitet i përkasin, me shenja dalluese të qarta sipas përkatësisë së aktivitetit të licencuar për të cilin janë përdorur.
2. Në çdo rast të tillë, I Licencuari duhet ti deklarojë ERE-s mënyrën e identifikimit të secilës faturë.
3. Të dhënat duhet të përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si:
  - a) kohëzgjatja,
  - b) rregullat e ofertës dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve,
  - c) sasinë, datat,
  - d) kohën e ekzekutimit të kontratës,
  - e) çmimet e transaksionit,
  - f) mjetet e identifikimit të klientëve me shumicë të përfshirë, detaje për të gjitha kontratat e papaguara
4. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të dhëna të caktuara, të deklaruara nga I Licencuari, me kusht që të mos publikohet informacioni që përbën sekret tregtar.

5. I Licencuari njofton menjëherë ERE-n për çdo situatë emergjente që ndikon në funksionimin e impiantit, duke përshkruar masat e marra.
6. I Licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes Aktivitetit të tij të Licencuar dhe tipeve të tjera të aktiviteve, në përputhje me Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s. I Licencuari do t'i paraqesë ERE-s, në kërkesen e tij, në formën dhe në afatin e vendosur nga ERE, dokumentacionin që vendos bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta mes aktiviteve që do të ushtrohen, si dhe rezultatet e arritura pas kësaj ndarje.
7. I Licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:
  - a) adresës;
  - b) statutit të të Licencuarit;
  - c) çertifikatës së regjistrimit;
  - d) NUIS-it
  - e) organeve kryesore drejtuese; ose
  - f) strukturës së biznesit të Licencuar.
8. Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me Licencën duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose përfaqësues ligjor i caktuar i të Licencuarit ose ERE-s, dhe të dërgohet me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e Palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit, ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.
9. I Licencuari do të dërgojë në ERE informacion Periodik lidhur me:
  - a) Shpenzimet dhe të ardhurat operative ( mujore, dhe në progresion 3-mujor);
  - b) Pasqyra Cash-Flow (mujore dhe progresive);
  - c) Tabela e të dhënave mbi sasitë e GNK-së me përmasa të vogla, të transportuara (mujore dhe progresive);
  - d) Çdo informacion të kërkuar rast pas rasti nga ERE;
  - e) Numrin e Klientëve për të cilët ka ofruar shërbimin e transportimit (mujore dhe progresive);
  - f) Grafikët e ngarkesës;
  - g) Sistemet e matjes;
  - h) Të dhëna mbi ankesat e rregjistruara, trajtimin dhe korrigjimet në faturimet përkatëse objekt ankimi (mujore dhe progresive);
  - i) Çdo informacion tjetër sipas Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kërkesave të raportimit të miratuara nga ERE sipas nenit 16 pika 24 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

## **Neni 5**

### **Përdorimi i Informacionit**

1. Licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë si rezultat i Aktivitetit të tij të Licencuar nuk do t'i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:
  - a) Jepet pëlqim paraprak me shkrim i Personit me të cilin lidhet informacioni;
  - b) Informacioni është bërë publik;

- c) Kur të Licencuarit i kërkohet ose lejohe të përhapë informacionin për të përmbushur Kushtet e kësaj Licence sipas një urdhëri të ERE-s, ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme;
- d) Informacioni duhet përhapur në funksion të kryerjes së aktivitetit të Licencuar.
2. I Licencuari do të sigurojë që çdo Biznes Shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion të të Licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion tek ndonjë Person tjetër (përfshirë Biznese të tjerë Shoqërues) që mund t'a mundësojnë këtë Person të fitojë çdo lloj përfitimi komercial të pajustificuar.
  3. Çdo Informacion me Avantazh Tregëtar në zotërim të të Licencuarit duhet të shpërndahet në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese dhe duhet të aksesohet lehtësisht dhe në mënyrë të barabartë nga konsumatorët aktuale dhe të mundshëm dhe palët e tjera të interesuara. Shpërndarja e Informacionit me Avantazh Tregëtar duhet të përpunohet për të parandaluar trajtimet preferenciale të konsumatorëve individual, pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror ose palëve të tjera të interesuara, në lidhje me fushëveprimin, përmbajtjen dhe/ose formën e informacionit të shpërndarë dhe/ose kohën kur ai është shpërndarë.
  4. I Licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur konfidencial informacionin në posedim të tij dhe për t'i raportuar ERE-s në përputhje me detyrimet Ligjore sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Kushteve të Përgjithshme për Furnizimin me Gaz Natyror dhe kontratën e furnizimit me gaz natyror.
  5. Informacioni i dërguar ERE-s nga i Licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të Licencuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.
  6. ERE ruan konfidencialitetin e Informacionit të Ndjeshëm Tregëtar të marrë nga i Licencuari sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara tek Rregulloret dhe Rregullat që aplikohen sipas neneve 16 pika 15 dhe 20 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
  7. I Licencuari nuk do të hyjë në marrëveshje të cilat i Licencuari e di ose duhet t'a dijë që çojnë në shkelje të Kushteve të Licencës.
  8. I Licencuari do të respektojë Ligjet dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Rregulloret e Rregullat e ERE-s.

## **Neni 6**

### **Pagesat e Rregullimit**

1. I Licencuari do t'i paguajë ERE-s pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj Licence siç përcaktohet nga ERE në rregulloren për pagesat e rregullimit si dhe nenin 14 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e Gazit Natyror”.
2. Nëse i Licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit brenda afatit të përcaktuar nga ERE, i Licencuari do të penalizohet në përputhje me Ligjin nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe “Rregulloren mbi Kushtet dhe Procedurat e Vendosijes së

Gjobave dhe Masën Konkrete për çdo Shkelje”, miraturar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 95, datë 04.07.2017.

### **Neni 7**

#### **Kontrolli mbi Kryerjen e Aktivitetit të Licencuar**

1. ERE do të monitorojë respektimin nga i Licencuari të Kushteve të Licencës, do të rishikojë raportet e marra nga I Licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të Licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të Licencuarit. Për këtë qëllim, ERE ndër të tjera duhet të ketë akses të pakufizuar tek llogaritë e të Licencuarit sipas neneve 30 dhe 31 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
2. Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të Licencuarit për të inspektuar Veprimtarinë e Licencuar sipas Rregullave të ERE-s. I Licencuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.
3. Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me iniciativën e vet, ERE mund të nisë një hetim administrativ për respektimin nga i Licencuari të Kushteve të Licencës ose Rregullave të ERE-s.
4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i Licencuari nuk i ka respektuar Kushtet e Licencës, ERE mundet të ndërmarrë masa të tjera brenda autoritetit të saj me qëllim që të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj Licence.
5. I Licencuari do t’informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të Kushteve të Licencës, jo me vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të Licencuarit.
6. I Licencuari do t’u bindet vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vëna nga ERE, sipas Legjislacionit në Fuqi.

### **Neni 8**

#### **Amendimi i Licencës**

1. ERE mund të ndryshojë/shfuqizojë Kushtet e Licencës në rast se ato nuk përputhen me:
  - a) Legjislacionin në fuqi dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që janë në përputhje me Legjislacionin në fuqi;
  - b) Vendimet e nxjerra nga një Gjykatë Shqiptare me kompetencë juridiksionale.
2. Në çdo kohë I Licencuari mund t’i propozojë ERE-s ndryshime të tjera të Kushteve të kësaj Licence, duke paraqitur një propozim me shkrim, së bashku me dokumentet mbështetëse. ERE mund të propozojë ndryshime të kushteve të kësaj Licence e ti konsultojë ato me palët e interesit përpara miratimit.
3. ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e klientëve dhe të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo ndryshim të propozuar. Nëse ERE dhe I Licencuari arrijnë një marrëveshje për këto ndryshime, Kushtet e Licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, I Licencuari mund të apelojë në Gjykatën Administrative Tiranë.

4. Të gjitha ndryshimet tek Kushtet e Licencës duhet të kryhen nga ERE sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Procedurës së Licensimit për Sektorin e Gazit Natyror dhe akteve të tjera nënligjore që aplikohen.
5. Amendimet e bëra në Kushtet e Licencës do të publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë

### **Neni 9**

#### **Vendosja e masave administrative dhe Heqja e Licencës**

1. Nëse i Licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj Licence, ERE mund të aplikojë masa administrative, sipas nenit 106 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, dhe “Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”.
2. ERE mund të heqë Licencën në përputhje me nenin 27 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe “Rregullores për procedurat e heqjes së Licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

### **Neni 10**

#### **Heqja e Licencës**

1. ERE heq një licencë kur i Licencuari:
  - a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të Licencës
  - b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
  - c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
  - d) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;
  - e) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;
  - f) me kërkesë të të licencuarit;
  - g) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas Licencës.
2. Licensa mund të hiqet nga ERE sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara tek Ligji nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Procedurave të Licensimit për Sektorin e Gazit Natyror, Rregullores mbi procedurat e refuzimit të licencës në Sektorët e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, si dhe Rregullave dhe Rregulloreve të tjera që aplikohen.

### **Neni 11**

#### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe e Drejta për Apelim**

1. Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të Licencuarit dhe çdo Pjesëmarrësi Tregu do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s.
2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE në bazë të kërkesës së çdo Personi që është palë në këtë mosmarrëveshje do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me nenin 98 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe “Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga

Konsumatorët dhe Zgjidhjes së Mosmarreveshjeve midis të Licencuarve në Sektorët e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 114 datë 08.07.2016

3. I Licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë.